



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2022:116612  
Datë: 24.06.2024  
Numri i dokumentit: 05849203

**K.Dh.Sh II.nr.305/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Tring TV” Sh.A., me numër të biznesit K61931005K dhe seli në Tiranë, Republika e Shqipërisë të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Ibrahim Dobruna, avokat nga Drenasi, kundër debitorit “Kujtesa Net” Sh.P.K., me numër të biznesit 70249238 dhe seli në Prishtinë, rr. “Ukshin Hoti”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini” me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1937/22 të datës 28.12.2023, me datë 24.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Tring TV” Sh.A., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1937/22 të datës 28.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1937/22 të datës 28.12.2023, në dispozitiv të

aktvendimit ka aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Kujtesa Net” Sh.P.K., me numër të biznesit 70249238 dhe seli në Prishtinë, ashtu që ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 208/2022, i lejuar më datë 12.05.2022, nga Përmbaruesi Privat Ilir Mulhaxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shklejeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarimore, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjës faktike si dhe për shkak të aplikimit të gabur të së drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1937/22 të datës 28.12.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori ka ushtruar përgjigje në ankesë nëpërmjet të cilës ka kërkuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e parashtruar nga ana e kreditorit ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1937/22 të datës 28.12.2023, të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, përgjigjes në ankesë, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Tring TV” Sh.A., ka paraqitur propozimin për përmbarim bazë të dokumenteve –faturës nr. 1179, e datës 31.08.2021; Faturës nr. 1196, e datës 30.09.2021; Faturës nr. 1198, e datës 30.10.2021; Faturës nr. 1115, e datës 30.11.2021; Faturës nr. 1500, e datës 31.12.2021; Faturës nr. 181/2022, e datës 31.01.2022, si dhe; Faturës nr. 561/2022, e datës 28.02.2022, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 208/2022 të datës 12.05.2022, me të cilin është urdhëruar debitori “Kujtesa Net” Sh.P.K., që në emër të përmbushjes së faturave brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën e përgjithshme prej EUR 525,000.00 (me shkronja: pesëqind e njëzet e pesë mijë Euro) me kamatëvonesë prej 8% sipas LMD-së, duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e

arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore në përputhje me UA-MD Nr. 06/2014.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin mbi lejimin e përbarimit, me arsyetim se përbaruesi privat nuk ka qenë kompetent për lejimin e urdhrin përbarimor për shkak se palët sipas marrëveshjes kanë deleguar një ligj tjetër dhe juridiksion tjetër, përkatësisht palët janë pajtuar që zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes palëve të bëhet nga Gjykata e Londrës nën aplikimin e ligjeve të Anglisë dhe Uellsit. Ndërsa, ka shtuar se debitori në përputhje me nenin 13 të marrëveshjes mes palëve ka paraqitur një padi pranë Gjykatës së Londrës ndaj të paditurit, këtu kreditorit për shkak të shkeljeve të dispozitave të marrëveshjes së ritransmetimit. Me tej, ka theksuar se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përbarimor nuk janë lëshuar përgjatë kohëzgjatjes së kontratës mes palëve dhe se të njëjtave ju mungojnë tiparet e përbarueshmërisë për arsye se të njëjtat nuk janë pranuar dhe as nënshkruar nga ana e debitorit, ashtu që debitori nuk ka pasur as mundësi që të njëjtat it kontestoj as për nga koha e arritjes së detyrimeve të pretenduara, e as për nga vëllimi dhe përmbajtja e tyre. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimi të pranohet si i bazuar, ashtu që urdhri përbarimor të shfuqizohet, ndërsa të obligohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të përpilimit të prapësimi.

Përfaqësuesi i autorizuar i kreditorit në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pabazuar dhe të pambështetur në prova, ndërsa ka shtuar se debitori nuk i është përmbajtur detyrimeve që derivojnë nga marrëdhënia e krijuar në mes të palëve duke mos i përmbushur detyrimet në emër të shërbimeve të cilat kreditori ia ka ofruar debitorit. Me tej, ka theksuar se debitori ka vazhduar të bëjë transmetime edhe pas ndërprerjes së marrëveshjes me kreditorin ndonëse ky i fundit ka qenë në proces të negocimit, lidhjes dhe renovimit të kontratave me shoqëri tregtare në Kosovë, shërbime këto të cilat arrijnë shumat si në faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përbarimor. Pra, ka theksuar se përkundër që marrëveshja mes palëve ka pushuar nga data 31.12.2019, debitori faktikisht ka vazhduar shfrytëzimin e të gjitha veglave mbi bazën e së cilave ka funksionuar transmetimi sipas marrëveshjes së vitit 2014. Poashtu, kreditori ka theksuar se pretendimet e debitorit se përbaruesi privat nuk ka juridiksion janë të pabazuara, ngase kompetenca e përbaruesit dhe gjykatës është përcaktuar në nenin 5.5 dhe 109 të LPP-së. Ndërsa, ka theksuar se padia e ushtruar nga debitori pranë gjykatave në Angli

ndaj kreditorit është e karakterit kontestimore dhe nuk mund të ketë ndikim në këtë çështje përmbartimore. Në fund, ka theksuar se pretendimet e debitorit se faturat nuk janë pranuar dhe as nënshkruar nga debitori janë përpjeke për prolongim të procedurës, ngase faturat i përmbajnë të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm konform dispozitave të LPP-së, ndërsa të njëjtat fatura debitori i ka pranuar sipas praktikave të bashkëpunimit që nga viti 2014 duke mos i kundërshtuar asnjëherë. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi si dhe të obligohet debitori që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet procedurale.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka vlerësuar se dokumentet e besueshme, përkatësisht faturat mbi bazën e të cilave është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokumente të besueshme, për arsye se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që këto fatura janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se të njëjtat janë pranuar nga debitori pa kundërshtime, për arsye se të njëjtave u mungon nënshkrimi apo vula e debitorit. Ndërsa, kreditori nuk ka arritur të dëshmoj se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit, ndërsa ky i fundit i ka pranuar faturat në fjalë dhe është njoftuar me detyrimin që rrjedhë nga to.

Gjykata Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm-faturës ku me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, përcaktohet se përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së është: Fatura. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për

përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar, e në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokumentet të besueshme, pasi që faturat nuk janë nënshkruar nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbardimit në kuptim të dispozitës së nenit 21 të LPP-së.

Pretendimi ankimor i kreditorit se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave kur ka vendosur mbi mospranimin e faturave sepse të njëjtat janë dërguar përmes postës elektrinike-e-mail. Gjkata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar, ngase në shkresa të lëndës nuk gjindet provë me të cilën e njëjtat ka konfirmuar pranimin e faturave përmesë e-mail-it, andaj kjo gjykatë vlerëson së për pranimin e faturave duhet të jenë të nënshkruara gjegjësisht të pranuar nga ana e debitorit. Në rastin konkret faturat nuk janë të nënshkruara nga ana e debitorit dhe si të tilla nuk mund të pranohen si dokument i besueshëm, në bazë të cilave mund të zhvillohet procedura përmbardimore, mirëpo kreditori mund të inicoj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij, varësisht nga suksesi nga ajo procedurë. Nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Gjkata vlerësoi pretendimet e tjera të kreditorit por të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbardimore, ngase nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbardimore prandaj edhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formal të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbardimi si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbardimi.

Përndryshe në procedurën përmbardimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbardimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbardues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbardimin.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**  
K.DH.SH.II nr.305/24 me datë 24.06.2024

Gjyqtarja,  
Franciska Zhitija- Ymeri